



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 21 gusht 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim për Miratimin e Përfundimit të Përfaqësimit të Kadri Veselit nga
Mbrojtësi**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Luka Mishetiq

Mbrojtjes së Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykses"), në bazë të neneve 21(4)(e), 40(2) e (6)(h) dhe 41(4)(b) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), rregullës 25 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave ("Rregullorja") dhe pjesës 16(1), (2)(b) dhe (4) të Direktivës për Mbrojtësit ("Direktiva"),¹ lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 8 gusht 2024, Administratorja i përcolli Trupit Gjykses letrat e Kadri Veselit ("z. Veseli") dhe mbrojtësit Ben Emerson ("z. Emerson" ose "mbrojtësi") lidhur me përfundimin e përfaqësimit nga mbrojtësi ("Transmetimi i Letrave").²
2. Më 20 gusht 2024, Administratorja i përcolli Trupit Gjykses dokumente të mëtejshme lidhur me kërkesën e z. Veseli për përfundimin para kohe të përfaqësimit nga z. Emerson si kryembrojtës ("Transmetimi i Dokumenteve të Mëtejshme").³
3. Më 21 gusht 2024, me kërkesë të Trupit Gjykses, palët konfirmuan në seancë private se nuk dëshirojnë të bëjnë parashtime për këtë temë.⁴

II. PARASHTRIMET

4. Në Transmetimin e Letrave, Administratorja njoftoi Trupin Gjykses për dy letra, një nga z. Veseli dhe një nga z. Emerson, ku kërkohet përfundimi para kohe i përfaqësimit nga mbrojtësi.⁵ Konkretisht, Trupi Gjykses u informua se: (i) më

¹ KSC-BD-04-Rev1, Udhëzues Pune i Zyrës Administrative, *Direktivë për Mbrojtësit*, 28 prill 2021.

² F02486, Administratorja, *Transmetim i Letrave të Kadri Veselit dhe Mbrojtësit të Specializuar lidhur me Përfundimin e Përfaqësimit nga Mbrojtësi*, 8 gusht 2024, konfidencial, me Shtojcat 1-2, konfidenciale. *Shih gjithashtu* CRSPD 552.

³ F02496, Administratorja, *Transmetim i Dokumenteve të Mëtejshme lidhur me Kërkesën e Kadri Veselit për Përfundimin Para Kohe të Përfaqësimit nga Mbrojtësi*, 20 gusht 2024, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale.

⁴ Transkripti i përkohshëm i seancës, 21 gusht 2024, f. 18851-18852, konfidencial.

⁵ Transmetimi i Letrave, para. 1.

7 gusht 2024, përmes bashkëmbrojtëses së z. Veseli, zonjës O'Rajli, Administratorja mori letër nga z. Veseli, ku ai kërkonte tërheqjen e mbrojtësit "për shkak të prishjes së pakthyeshme të marrëdhënies klient-mbrojtës";⁶ dhe se (ii) më 8 gusht 2024, me anë të një letre, z. Emerson njoftoi Administratoren për tërheqjen e tij të parakohshme si mbrojtës, pas vendimit të z. Veseli për shkarkimin e mbrojtësit nga detyra.⁷

5. Në Transmetimin e Dokumenteve të Mëtejshme, Administratorja njoftoi Trupin Gjyqësor se, më 16 gusht 2024, përmes bashkëmbrojtëses, Zyra Administrative mori formularin e nënshkruar ku z. Veseli kërkon emërimin e z. Rodni Dikson ("z. Dikson") si kryembrojtësin e tij të ri, dhe formularin e nënshkruar të aktit të përfaqësimit në mbështetje të kërkesës.⁸

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Dispozitat ligjore të zbatueshme në lidhje me caktimin dhe tërheqjen e mbrojtësve janë shtjelluar gjerësisht në vendime të mëparshme të Trupit Gjyqësor.⁹

IV. DISKUTIM

7. Në shqyrtimin e Transmetimit të Letrave dhe Transmetimit të Dokumenteve të Mëtejshme, Trupi Gjyqësor mban parasysh të drejtën e z. Veseli sipas nenit 21(4)(e) të Ligjit për të zgjedhur mbrojtësin e vet. Sa u takon arsyeve të vlefshme, Trupi Gjyqësor vëren se si z. Veseli, ashtu edhe z. Emerson, konfirmuan vendimin e tyre për përfundimin e marrëdhënies avokat-klient për shkak të "prishjes së

⁶ Transmetimi i Letrave, para. 2, që i referohet Shtojcës 1 së Transmetimit të Letrave.

⁷ Transmetimi i Letrave, para. 3, që i referohet Shtojcës 2 së Transmetimit të Letrave.

⁸ Transmetimi i Dokumenteve të Mëtejshme, para. 2, që i referohet Shtojcës 1 të Transmetimit të Dokumenteve të Mëtejshme.

⁹ F02121, Trupi Gjyqësor, *Vendim për Miratimin e Përfundimit të Përfaqësimit të Hashim Thaçit nga Mbrojtësi*, 14 shkurt 2024, para. 16-20; F01493, Trupi Gjyqësor, *Vendim për Miratimin e Tërheqjes së Mbrojtësit të Rexhep Selimit*, 1 maj 2023, para. 4-5.

pakthyeshme të marrëdhënies klient-mbrojtës”.¹⁰ Mbi këtë bazë, Trupi Gjykses është bindur se janë dhënë arsye bindëse, brenda kuptimit të pjesës 16(2)(b) të Direktivës, për përfundimin para kohe të përfaqësimit të z. Veseli nga z. Emerson.

8. Për sa i takon vijimësisë së përfaqësimit, Trupi Gjykses vëren se Administratorja parashtron se: (i) ekipi i Mbrojtjes së z. Veseli aktualisht përbëhet nga njëmbëdhjetë persona, konkretisht një mbrojtës, tre bashkëmbrojtës, gjashtë ndihmës juridikë/administrativë të ekipit, dhe tre praktikantë;¹¹ (ii) si z. Veseli, ashtu edhe z. Emerson shprehen se i akuzuari do të vijojë të përfaqësohet nga bashkëmbrojtëset znj. O’Rajli dhe znj. Rouan;¹² (iii) në letrën e tij, z. Emerson u shpreh se “do të përpiqet të garantojë që tërheqja e tij të mos dëmtojë z. Veseli gjatë periudhës kalimtare dhe që interesat [e z. Veseli] të mbrohen”;¹³ dhe (iv) siç pritej,¹⁴ Administratorja mori, përmes bashkëmbrojtëses, formularin e nënshkruar ku z. Veseli kërkon emërimin e z. Dikson si mbrojtësin e tij të ri, si dhe formularin e nënshkruar të aktit të përfaqësimit në mbështetje të kërkesës.¹⁵ Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se Administratorja parashtron se, në qoftë se Trupi Gjykses do të miratojë përfundimin e përfaqësimit të z. Veseli nga z. Emerson sipas pjesës 16(2)(b) të Direktivës për Mbrojtësit, Administratorja është në gjendje të ndërmarrë masa të menjëhershme për caktimin e z. Dikson si mbrojtës zëvendësues të z. Veseli, në përputhje me kriteret e pjesëve 5 dhe 13 të Direktivës për Mbrojtësit, për të garantuar që z. Veseli të jetë i përfaqësuar me mbrojtës në çdo kohë.¹⁶ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses bindet se do të sigurohet vijimësia e përfaqësimit të z. Veseli.

¹⁰ Transmetimi i Letrave, para. 2-3, që i referohen Shtojcave 1-2 të Transmetimit të Letrave; Transmetimi i Dokumenteve të Mëtejshme, para. 1. Shih gjithashtu më sipër, para. 4.

¹¹ Transmetimi i Letrave, para. 5.

¹² Transmetimi i Letrave, para. 5, që i referohet Shtojcave 1-2 të Transmetimit të Letrave.

¹³ Transmetimi i Letrave, para. 5, që i referohet Shtojcës 2 të Transmetimit të Letrave.

¹⁴ Transmetimi i Letrave, para. 5.

¹⁵ Transmetimi i Dokumenteve të Mëtejshme, para. 2. Shih gjithashtu më sipër, para. 5.

¹⁶ Transmetimi i Dokumenteve të Mëtejshme, para. 3.

9. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykues gjykon se kërkesa për përfundimin para kohe të përfaqësimit të z. Emerson si mbrojtës i z. Veseli përputhet me të drejtat e z. Veseli dhe siguron përshtatshëm përfaqësim të efektshëm. Trupi Gjykues bindet se zëvendësimi nuk do t'i shkaktojë padrejtësi z. Veseli ose të bashkakuzuarve të tij. Trupi Gjykues bindet gjithashtu se ndërrimi i kryembrojtësit nuk do të shkaktojë vonesa në procesin gjyqësor. Në këtë aspekt, Trupi Gjykues vëren se z. Veseli do të vijojë të ndihmohet nga dy mbrojtës të tjerë, të cilët kanë kohë që janë përfshirë në këtë çështje.

10. Për këto arsye, Trupi Gjykues miraton tërheqjen e z. Emerson si mbrojtës i z. Veseli. Përfundimi i përfaqësimit të z. Emerson si mbrojtës i z. Veseli do të hyjë në fuqi ditën kur Administratorja të emërojë kryembrojtësin e ri për të përfaqësuar z. Veseli. Në këtë aspekt, Trupi Gjykues fton Administratoren të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për emërimin e kryembrojtësit të ri të z. Veseli sa më shpejt që të jetë e realizueshme.

V. KLASIFIKIMI

11. Trupi Gjykues vëren se Transmetimi i Letrave dhe Transmetimi i Dokumenteve të Mëtejshme janë klasifikuar si konfidenciale sepse kanë të bëjnë me aspekte të përfaqësimit juridik të z. Veseli për të cilat ende nuk është marrë vendim. Trupi Gjykues udhëzon Administratoren të dorëzojë versionin e redaktuar publik të këtyre parashtrimeve, ose të kërkojë riklasifikimin e tyre si publike sipas rregullës 82, deri të premtën, 30 gusht 2024.

VI. VENDIM

12. Për arsyet e sipërpërmendura, Trupi Gjykues:

- (a) **MIRATON** përfundimin e përfaqësimit të z. Emerson si mbrojtës i z. Veseli, që hyn në fuqi ditën kur Administratorja të emërojë kryembrojtësin e ri për të përfaqësuar z. Veseli;
- (b) **FTON** Administratoren të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për emërimin e kryembrojtësit të ri për z. Veseli sa më shpejt që të jetë e realizueshme; dhe
- (c) **UDHËZON** Administratoren të dorëzojë versionet e redaktuara publike ose të kërkojë riklasifikimin si publike të Transmetimit të Letrave dhe të Transmetimit të Dokumenteve të Mëtejshme, deri të **premtën, 30 gusht 2024**.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E mërkurë, 21 gusht 2024

Në Hagë, Holandë.